

**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI”, VLORE  
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE**

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT DHE E PRANIMIT TË  
KANDIDATËVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË  
MASTER I SHKENCAVE NË SHKENCA KOMPJUTERIKE**

**Vlorë, Maj 2019**

# **Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimeve Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike**

## **Kreu I**

### **Neni 1**

#### **Të dhëna të përgjithshme**

- a. Programi i studimit i ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Shkencave Kompjuterike është pjesë e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike bazuar në VKM Nr. 512, date 08.11.2010.

### **Neni 2**

#### **Misioni dhe objekti i Rregullores së Programit të Studimit Masterit të Shkencave**

- a. Rregullorja përcakton misionin e programit të studimit dhe vendos rregullat normative të organizimit të tyre, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve, rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores.

### **Neni 3**

#### **Programi i ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Shkencave Kompjuterike**

- a. Programi i studimit "Master i Shkencave" në Shkencave Kompjuterike pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në fushën e Shkencave Kompjuterike.
- b. Ky program organizohet dhe realizohet me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;
- c. Studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Shkencave Kompjuterike përmbyllet me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në Shkencave Kompjuterike.

### **Neni 4**

#### **Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve**

- a. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të vendosura në Departamentin e Shkencave Kompjuterike;
- b. Kriter pranimi në programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Shkenca Kompjuterike është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht.
- c. Kandidatit i njohen kreditet e përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional", me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit "Master i Shkencave".

### **Neni 5**

#### **Organizimi i studimeve të ciklit të dytë**

- a. Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike zhvillohet me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale është dy vite akademike.
- b. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet;

- c. Numri i krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin e studimit me kohë të plotë “Master i Shkencave” në Shkenca Kompjuterike është 60 kredite. Studenti në fund të këtij programi grumbullon 120 kredite;
- d. Studenti mund të vijojë pjesëmarrjen në programin master i shkencave edhe mbi kohën normale të studimeve. Në këtë rast ai duhet të shlyejë detyrimet sipas planit mësimor dhe paguajë tarifat përkatëse;
- e. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studentit gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e saj;
- f. Ky program studimi është organizuar në module dhe të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);

## Neni 6

### Gjuha e zhvillimit të programit

- a. Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit Master i Shkencave në **Shkenca Kompjuterike është gjuha shqipe ose gjuha angleze;**
- b. Në semestrin e dytë të vitit të dytë zhvillohet mbrojtja e diplomës. Diploma është një punim i pavarur shkencor i studentit të programit të studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike;
- c. Leksionet zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i Fakulteti ku kryhet programi i studimit;
- d. Kohëzgjatja e orës mësimore është 60 minuta;
- e. Kontrolli i dijeve në çdo modul bëhet nëpërmjet vlerësimit të detyrave të kursit, pjesëmarrjes dhe vlerësimit në seminare, në punët laboratorike dhe provimit;
- f. Detyrimet për të vijuar në vitin paraardhës janë si vijon:

Frekuentimi (leksione, seminare, ushtrime, laborator) është i detyrueshëm në masën 75%. Studentët, të cilët nuk plotësojnë këtë masë frekuentimi, humbasin të drejtën për t'u paraqitur në provim në atë modul dhe e rifitojnë këtë të drejtë duke plotësuar deficionin e krijuar në vitin akademik pasardhës;

Për të kaluar në vitin e dytë (semestri i tretë), në Master i Shkencave studentit duhet të ketë fituar minimumi 30 kredite.

Në sezonin e vjeshtës (muaji shtator) paraqiten për shlyerjen e provimeve vetëm studentët e rregullt që kanë rezultuar të pa suksesshëm në vitin aktual;

## Kreu II KONTROLLI I DIJES

### Neni 7

#### Sistemi i vlerësimit

- a. Në programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota (nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal). Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. **Notat nga 5 (pesë) e lartë janë kaluese.**

- b. Në rastin e organizimit të moduleve të përbërë ku marrin pjesë më shumë se një disiplinë, vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara, ose shlyerjes së modulit me pjesë. Në të dyja rastet vlerësimi përfundimtar do të shprehet nëpërmjet një note mesatare të ponderuar, ku merret në konsideratë vlerësimi dhe kreditet për çdo pjesë të shlyer.
- c. Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë, apo të modulit të caktuar merren në konsideratë të gjithë elementët përbërës të zhvillimit të lëndës: pjesa teorike, detyrat, projektet, laboratorët, frekuentimi, etj. Shkalla e rëndësisë së secilit element në vlerësimin përfundimtar është e percaktuar në syllabusin e lëndës ku projektet vlerësohen 20%-40% dhe provimi final 60%-80%.

### **Neni 8**

#### **Parakushtet për hyrje në provim**

- a. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur:
  - i. ka plotësuar kriteret detyruese të vendosura për atë lëndë të parashikuara në planin mësimor;
  - ii. e lejon grafikun e ndërvarësisë së lëndëve;
  - iii. plotëson kushtet që lidhen me frekuentimin e formave mësimore;
  - iv. ka mbrojtur detyrimet për praktikën mësimore, punët laboratorike, nëse lënda parashikon forma të tilla, brenda afatit të parashikuar në grafikun e detyrimeve, para fillimit të sezonit të provimeve;
  - v. të jetë regjistruar në sekretarinë mësimore për dhënie provimi në sesionin dhe datën përkatëse;
  - vi. ka paguar tarifën e shkollimit;
- b. Studenti i cili nuk plotëson këto parakushte nuk lejohet për asnjë lloj arsye të hyjë në provimin e lëndës përkatëse.

### **Neni 9**

#### **Përmirësimi i notave**

- a. Studenti ka të drejtë të kërkojë të përmirësojë notën. Një veprim i tillë lejohet kur nota që kërkon të përmirësojë studentin është e një detyrimi të vitit që ai sapo ka mbyllur. Studenti ka të drejtë të përmirësojë deri në 2 (dy) lëndë gjatë dy viteve të studimit. Ai nuk ka të drejtë të përmirësojë notën e lëndës speciale.
- b. Për përmirësimin e notës, studentët do provohen vetëm një herë dhe vetëm në sezonin e vjeshtës. Mbetet në fuqi nota me të cilën studentin vlerësohet në fund.

## **Kreu III**

### **DIPLOMIMI**

#### **Neni 10**

#### **Modalitetet e diplomimit**

- a. Në përfundim të programit të studimit "Master i Shkencave" në Shkencave Kompjuterike, studentët marrin diplomën e titulluar "Master i Shkencave" në Shkencave Kompjuterike shoqëruar me Suplementin e diplomes.
- b. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve siç parashikohen nga plani dhe programet mësimore të.

## Neni 11

### Përgatitja e diplomës

- a. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit dhe përcakton programin e punës së diplomantit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të përfundimit të çdo pikë të programit. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur realizimin me sukses të temës teorike si dhe të programit artistik në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës.
- b. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar.
- c. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit. Udhëheqësi mban shënimet përkatëse në lidhje me ecurinë e studentit në përgatitjen e diplomës nga studentit.
- d. Departamenti organizon kontrole periodike, në të cilat kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e kryerjes së tyre. Përgjatë këtyre kontrolleve mund të rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të temës, të cilat nuk përmbysin thelbin e punimit.
- e. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës dhe ka kryer të gjitha kontrollet në departament. Për këtë Udhëheqësi jep mendimin e tij me shkrim, ku deklarohet se volumi i planifikuar i punës është kryer dhe studentit është gati për mbrojtjen e Diplomës.

## Neni 12

### Të drejtat e studentëve

Studentët kanë të drejtë:

- a. Të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
- b. Të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;
- c. Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e institucionet parashikuar për studentë, në përputhje me këtë ligj dhe statusin e institucionit;
- d. Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit.
- e. Të përdorë pajisjet e universitetit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit;
- f. Të përfaqësohet në këshillin e fakultetit dhe senatin e universitetit në përputhje me rregulloret përkatëse të këtyre organeve.
- g. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të këshillit të ministrave, senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare;
- h. Të ndjekë sudimet në një degë të dytë, në sistem të ndryshëm nga ai që ndjek, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, në vendimet e senatit apo në aktet e posaçme të ministrisë së arsimit dhe të shkencës.
- i. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit
- j. Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagogëve, të mosrealizimit të procesit të mësimdhënies, të rregullave të zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin e tij të pamërituar.
- k. Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që çënon integritetin e studentit.

## **Neni 13**

### **Përgjegjësitë e studentit**

Studenti është i detyruar:

- a. Të njohë me hollësi rregullat e universitetit e detyrimet e tij dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre; në të kundërt, universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre;
- b. Të njohë të gjitha kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur. Studentët janë përgjegjës për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që ata synojnë;
- c. Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga statuti i universitetit, nga kjo rregullore dhe nga çdo akti tjetër ligjor e nënligjor për arsimin e lartë;
- d. Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe programet e lëndëve, si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt fakultetit dhe universitetit, sipas përcaktimeve ligjore;
- e. Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të shkollës nga ana e tij; dëmi material që ai mund të ketë bërë zhdëmtohet në masën e përlllogaritur.
- f. Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.
- g. Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitojnë një paraqitje të keqe të punës.
- h. Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.
- i. Të evitojnë aparcencën e mashtrimit (të lënit përshtypje sikur po mashtrojnë). Nëse studentët janë të bindur që praktikat e përdorura nga pedagogu janë të favorshme ndaj mashtrimit, ata mund t'ia përcjellin këtë mesazh pedagogut, përgjegjësit të departamentit, ose një anëtar të komisionit të sjelljes akademike, student/pedagog (ose drejtpërsëdrejti, ose me anë të zyrës së dekanit të studentëve). Nëse komisioni i sjelljes akademike vendos se është vënë re sjellje e keqe akademike, atëherë komisioni cakton ndëshkimin, i cili mund të variojë nga vërejtje disiplinore, “paralajmerim”, pezullim të përkohshëm e deri në përjashtim (pushim nga puna) nga universiteti.

**Miratoi**

**Përgjegjëse e Departamentit të Shkencave Kompjuterike**

**Dr. Eljona PROKO**